



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:139559

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05607310

Ac.nr.5124/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A (S) N nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.Z., avokat nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.O., për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.388/18 të datës 10.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.388/18 i datës 10.08.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.388/18 të datës 10.08.2020, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit dhe ka vërtetuar se paditësi A (S) NurkNasa është pronar i parcelës nr..., që gjendet në vendin e quajtur “S”, në sipërfaqe prej 3441 m2, në bazë të mbajtjes me mirëbesim-parashkrim fitues dhe e ka obliguar të paditurën që ta pranoj këtë të drejtë dhe të lejoj që paditësi në regjistrin e pronave pranë Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës të Komunës së Rahovecit të evidentohet si pronar, ku si bazë juridike do të shërbej ky aktgjykim, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumën prej 565,00 euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, të aprovet si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit, të prishet në tërësi aktgjykimi i shkallës së parë dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar paditësi duke i kontestuar të gjitha pretendimet ankimore të t 'paditurës me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën e të paditurës ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj si të drejtë dhe me bazë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 20.06.2017 paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës për vërtetimin e pronësisë, me kërkesë dhe arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.388/18 të datës 10.08.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimi të ankimuar gjykata ka bërë nxjerrjen dhe administrimin e provave materiale përfshirë edhe ekspertizën e gjeodezisë e po ashtu ka bërë nxjerrjen e provës edhe me dëgjimin e dëshmitarëve B.R. dhe N.N., nga të cilat prova gjykata ka arsyetuar se ka vërtetuar faktin se parcela kontestuese ka qenë e evidentuar në emër të gjyshit të paditësit- A (J) N dhe se me futjen në përdorim të kadastrit të ri matës në vitin 1965 ngastra kontestuese është regjistruar si pronë shoqërore KK Rahovec e që sipas gjendjes së fundit del të jetë pronë shtetërore. Ka arsyetuar po ashtu se me procesverbalin e përpiluar me datë 20.11.1964 është vërtetuar fakti se ngastra lëndore është dhuruar për interesin publik nga dhuratëdhënës A (J) N i konstatuar si i tillë në procesverbal- mirëpo procesverbali është nënshkruar nga I (J) N-kushëriri i paraardhësit të paditësit e jo nga pronari. Ka shtuar se nga dëshmitë e dëshmitarëve ka vërtetuar faktin se ngastra lëndore është punuar dhe ka qenë në posedim në mënyrë të pa ndërprerë fillimisht nga i ati i paditësit deri sa i njëjti ishte gjallë ndërsa tani në shfrytëzim të paditësit dhe se edhe i ati i paditësit dhe tani paditësi asnjëherë nuk janë penguar në shfrytëzimin e ngastrës lëndore qoftë nga organet komunale apo edhe nga ndonjë person fizik. Ka arsyetuar se nga provat e paraqitura është vërtetuar fakti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues meqë paluajtshmërinë lëndore e ka në posedim më shumë se njëzet vite kurse është irelevant fakti gjegjësisht pretendimi

i të paditurës se paluajtshmëria është e evidentuar në emër të t 'paditurës ngase bazuar në dispozitat ligjore evidenca nuk është e vetmja dëshmi as për humbjen e as për fitimin e pronësisë. Në fund ka shtuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 28 par.4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore dhe nenit 40 par.1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore kërkesëpadia e paditësit del të jetë e bazuar dhe si e tillë është aprovuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e përkrah Gjykata e Apelit ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) dhe neni 182.1 lidhur me nenin 160. 4 të LPK-së . Gjendja faktike po ashtu del të mos jetë hetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, me çka për rrjedhojë ka pas edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërtënie me arsyet e aktgjykimit dhe për faktet vendimtare aktgjykimi nuk përmban arsye. Sipas dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së përcaktohet se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar këto fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*, ndërsa në paragrafin 5 parashihet që: *“Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor”*. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktgjykimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve, respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla për të arritur deri te përfundimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë.

Aktgjykimi i ankimuar është përfshirë edhe në shkelje përkitazi me gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë jo të plotë dhe të drejtë, për shkakun se gjykata e shkallës së parë me provat e administruara nuk ka arritur të vërtetoj faktet përkitazi me posedimin e ngastrës lëndore fillimisht nga paraardhësi i paditësit e pastaj edhe nga paditësi. Kjo ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka arsyetuar *se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë nga baza e parashkrimit- mbajtjes për më shumë se 20 vite dhe se parcela kontestuese ka qenë pronë e gjyshit të tij A (J) N mirëpo me futjen në përdorim të kadastrit të ri matës në vitin 1965 ngastra kontestuese është e regjistruar si pronë shoqërore KK Rahovec, ndërsa procesverbali i dt. 20.11.1964 me të cilin prona lëndore është dhuruar për interes publik nuk është nënshkruar nga pronari i ngastrës A (J) N i cili kishte ka vdekur në vitin 1950, por ishte nënshkruar nga I (J) N-kusheriri i paraardhësit të paditësit, mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar*

faktin nëse paditësi apo eventualisht edhe paraardhësi i paditësit e ka pasur të njohur faktin se kjo paluajtshmëri i është dhuruar për interes publik Komunës së Rahovecit dhe nëse eventuaisht dhurimi i kësaj paluajtshmërie është kundërshtuar ndonjëherë çoftë nga paraardhësi i paditësit e madje edhe nga vet paditësi, fakte këto nga të cilat do të vërtetohej nëse poseduesi (mbajtësi) nuk e ka ditur ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, e në mënyrë që posedimi të mund të konsiderohet se është me mirëbesim.

Për shkak të konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata ankimore vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga shkak se e drejta materiale mund të zbatohet drejtë vetëm në rastin kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 28 par.4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore, duke vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara me këtë dispozitë ligjore, me të cilën shprehimisht parashihet se: *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*, pa e vërtetuar faktin nëse poseduesi i ngastrës lëndore ka qenë me mirëbesim respektivisht nëse i njëjti e ka ditur apo jo faktin se kjo ngastër është dhuruar për interes publik Komunës së Rahovecit nga parardhësit e tij .

Të gjeturat e konstatuara si më lart aktgjykimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë u dashtë që të priset dhe lënda t’i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, e cila në riprocedurë udhëzohet që ti eliminojë shkeljet e konstatuara si më lart nga kjo gjykatë ashtu që me rastin e vendosjes duhet të vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare përkitazi me kërkesën e padisë, duke e vërtetuar faktin nëse posedimi i paluajtshmërisë nga ana e paditësit është me mirëbesim pra nëse e ka pasur të ditur faktin se paluajtshmëria është dhuruar për interes publik dhe nëse rezulton se ka pasur njohuri për këtë a është kundërshtuar dhurimi i saj nga ana e paditësit apo eventualisht paraardhësit të tij me pretendimin e paraqitur edhe në padi se procesverbali nuk është nënshkruar nga pronari i ngastrës, mandej gjykata duhet të vlerësojë se a janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues dhe të vlerësojë faktin se paluajtshmëria lëndore-si pronë shoqërore a mund të fitohet me parashkrim fitues, dhe varësisht nga të gjeturat eventuaisht të nxirren dhe prova tjera në mënyrë që të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike, e që pastaj duke e zbatuar drejtë të drejtën materiale, të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t’i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimin të drejtë.

Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësit, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore u dashtë që të priset dhe gjykatës së shkallës së

parë t'i kthehet në rigjykim, me çka në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe dhënies shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5124/20, me datë 08.04.2024.

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v.